



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.433/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti dhe Violeta Husaj Rugova anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.02.2025, merr këtë :

**V E N D I M**

**REFUZOHEN TË PABAZUARA** ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, A.nr.433/2025 dhe A.nr.439/2025 të datës 07.02.2025, parashtruar kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025

**A r s y e t i m**

Me datën 07.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat identifikuar me numër A.nr.433/2025 dhe A.nr.439/2025 me datën 07.02.2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Në ankesën A.nr.433/2025 pretendohet se më datë 6 shkurt 2025, aktivistët e Qendrës së Vetëvendosjes në Gjilan kanë vërejtur se mbështetësi i subjektit politik LDK, z.Nusret Avdiu përmes rrjeteve sociale në videon live të tubimit elektorale të LDK-së, në Gjilan ka postuar komente fyese dhe denigruese ndaj Lëvizjes Vetëvendosje! me sa vijon: "*kanë shku në Serbia ata 118*"

I njëjti po ashtu duke iu referuar numrit në fletëvotim të LVV-së, 118 ka komentuar me fjalë fyese me sa vijon: "po vjen era m... 118"

Përveç komenteve i lartcekuri ka shpërndarë dhe foto me përshkrim montazh dhe shprehje fyese ndaj kandidatit të LVV-së, për deputet z.Agim Bahtiri.

Ankesës si prove i ka bashkangjitur: linkun e profilit në Facebook <https://www.facebook.com/nusret.avdiu>

2.CD (Foto-postimi) 3.Provë: Foto postimi

Në ankesën A.nr.439/2025 pretendohet se më datë 6 shkurt 2025, kandidati për deputet i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), z. Lutfi Haziri në tubimin elektoral të mbajtur me qytetarë në qytetin e Gjilani ndër të tjera ka deklaruar se: *"besimi qytetar nuk mund të blihet me mashtrim ofertë të rrejshme e as me premtime te cilat nuk i realizon.*

Në vazhdim të ankesës theksojnë se po të njejt tubim elektoral i lartcekuri ka deklaruar se: *"Kryeministi Kurti e ka bërë autostradën autolloq, stadiumin e qytetit e ka bërë grope të zezë, dhe për 20 mijë aimpatizantë që marrin shërbime është grope e frikshme"*

Ankesës si prove i ka bashkangjitur: Provë:CD (deklarimi)-1, CD (deklarimi)-2

Sipas parashtruesit të ankesave këto veprime, nga mbështetsi i subjektit politik Nusret Avdiu dhe kandidati për deputet i LDK-së, në zgjedhjet parlamentare të datës 09.02.2025, z.Lutfi Haziri ka shkelur dispozitat e nenit 34 pika 1.11 e LZP-së, duke përhapur gjuhë të urrejtjes dhe shpifjes që do të mund të nxiste sulm ndaj të tjerëve.

Duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojnë nga PZAP-i që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përgjigjet në ankesat e subjektit politik Subjekti politik LDK, theksohet se: Pretendimet në ankesën A.nr.433/2025 , se nje qytetar me emrin Nusret Avdiu me rastin e komentit të tij në rrjetin social facebook ka shkelur nenin 34 paragrafi 1 , nenparagrafi 1.1 1 te Ligjit per Zgjedhjet e Pergjithshme, eshte ligjerisht i diskutueshem dhe nje çështje e tillë është opinion apo mendim i dikujt rreth dickaje qe eshte krejtesisht personale dhe nuk mund t'i mvishet subjektit politik, ngase ne krejt fushaten gillha politike e kultura dhe etika e subjektit LDK ka qene e nivelit gati superior.

Duke marrë parasysh ato që u cekën më lartë kerkojnë nga PZAP që të marr vendim meritor per rastet në fjalë dhe duke u bazuar në krejt ato që u thanë kërkojnë që ankesat e subjektit politik LVV, të refuzohet si e papbazuar

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: A.nr.433/2025 dhe A.nr.439/2025 të datës 07.02.2025., janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.433/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik LVV kundër subjektit të njëjtë politik LDK, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

**-Ankesat janë të pabazuara.**

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave materiale te bashkangjitura, ka gjetur se personi i quajtur Nusret Avdiu ka shpërndarë një postim në rrjetin social Facebook, me tekst shoqërues, në të cilën shkruan *"kanë shku në Serbia ata 118"* si dhe disa komente dhe fotografia tjera ofenduse për subjektin LVV. Po ashtu deklarimi i kandidatit për deputet nga subjekti politik LDK, Lutfi Haziri se: *"besimi qytetar nuk mund të blihet me mashtrim ofertë të rrejshme e as me premtime te cilat nuk i realizon, dhe: "Kryeministi Kurti e ka bërë autostradën autolloq, stadiumin e qytetit e ka bërë grope të zezë, dhe për 20 mijë simpatizantë që marrin shërbime është grope e frikshme"* Paneli vlerësoi se në rastin konkret lidhur me mbështetësin në fjalë nuk kemi të dhëna qe e bëjnë të besueshëm faktin se kemi të bëjmë me mbështetës apo kandidat të subjektit politik LDK,

andaj nuk mund të konsiderohet se është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin nen në mënyrë shprehimore thuhet se: "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".

Si dhe deklaratat e kandidatit për deputet të lartcekur, sipas vlerësimit të Panelit asnjë nga këto deklarata nuk përbëjnë asnjë shkelje të nenit 34 paragrafi 1, nen paragrafi 1. 11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe janë në përputhje me diskursin e fushatës zgjedhore dhe i njëjti nuk ka fyer, fyer, degraduar apo urrejtje ndaj subjektit politik Vetëvendosje dhe nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore.

Andaj duke u mbështetur në nenin 17.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lart.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi I të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

## PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

A.nr.433/2025 më datën 10.02.2025



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.